

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ANETAREVE**

**V E N D I M**

Nr. 22 Datë 06.11.2019

**"MBI MIRATIMIN E KRITEREVE PER EMERIMIN E KORRESPONDETEVE  
NE SHOIPERI"**

Në zbatim të Ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 "Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit", Ligjin Nr. Ligjin Nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Rregullores se Brendshme te Keshillit te Byrove, Statutit te BSHS, Vendimit nr.12,date 25.06.2019, Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve , në mbledhjen e datës 06.11.2019 ,me shumicën e nevojshme të votave:

**V E N D O S I:**


1. Miratimin e kriterëve për emërimin e korrespondentëve në Republikën e Shqipërisë
2. Në zbatim të pikës 1, korrespondent mund jetë :

• një shoqëri sigurimi që përmbush kriteret ligjore në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 "Mbi Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit", Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 "Mbi Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit", dhe që është anëtare e Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe e autorizuar për të lëshuar policën e detyrueshme të përgjegjësisë ndaj palëve të treta (TPL).

• një ent ligjor, i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për trajtimin e dëmeve si trajtues, i cili duhet të plotësojë kriteret si vijon :

(i) Të jetë i organizuar në formën e shoqërisë tregtare " sh.a ";

(ii) Të ketë kapital jo më të vogël se 3 000 000 ( tre milion ) Euro në trajtën e e mjeteve monetare likuide të depozituar paraprakisht në një llogari qëllimore gjatë gjithë kohës së ushtrimit të aktivitetit si korrespondent.Kjo llogari mund të preket për



pagesa vetëm me urdhër të BSHS. Shoqëria ka detyrimin në çdo rast të plotësojë gjëndjen e mjeteve monetare të prekura nga BSHS menjëherë.

(iii) Të ketë një rrjet të plotë ekspertësh, vlerësuesish dhe juristësh të provuar me dokumente paraprakisht

(iv) Të ketë një eksperiencë minimale prej 10 ( dhjete) vitesh në tregun e sigurimeve si shoqëri e licensuar në trajtimin e dëmeve

(v) Të marrë miratimin nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve vetëm nëse plotëson të gjitha kriteret e mësipërme

3. Ngarkohet Ekzekutivi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit të dërgojë për miratim pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare kriteret në Rregulloren bashkëlidhur.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a**

Avni



**INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP sh.a**

Gentian Sula

**ATLANTIK sh.a**

Dritan Çelaj




**SIGMAINTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP**

Klaidi Citozi

**INSIG sh.a**

Areta Çuko




**ALBSIG sh.a**

Muharrem Bardhoci

**EUROSIG sh.a**

Xhevdet Kopani



**ANSIG sh.a**

Edlir

Ruka

## Rregullore

### “Mbi Procedurat dhe Kriteret per Emerimin e Korrespondenteve ne Shqiperi”

Ne perputhje me Rregulloren e Brendshme dhe legjislacionin e aplikueshem ne territorin shqiptar per sigurimin/risigurimin dhe TPL-ne e detyrueshme, Byroja Shqiptare e Sigurimit ka parashikuar kriteret per emerimin e korrespondenteve lidhur me aksidentet motorike te ndodhura ne Shqiperi.

#### Neni 1 Qellimi

Kjo rregullore ka per qellim te parashikojë rregullat, kushtet dhe kriteret, bazuar ne te cilat Byroja Shqiptare e Sigurimit miraton, refuzon ose shfuqizon emerimin e korrespondenteve te themeluar ne vendin per te cilin eshte kompetente, te cilet trajtojne kerkesat per demshperblim qe rrjedhin nga aksidentet e shkaktuara nga mjetet per te cilat siguruesi ose siguruesit ne fjale kane leshuar nje police sigurimi dhe qe ndodhin ne territorin shqiptar.

#### Neni 2 Perkufizime

“Korrespondent” do te quhet cdo sigurues ose person juridik i emeruar nga nje ose me shume sigurues, me miratimin e Byrore se vendit ku eshte themeluar, me qellimin per te trajtuar kerkesat per demshperblim qe rrjedhin nga aksidentet e shkaktuara nga mjetet per te cilat siguruesi ose siguruesit ne fjale kane leshuar nje police sigurimi dhe qe ndodhin ne territorin shqiptar.

#### Neni 3 Entet qe mund te veprojne si Korrespondent

Korrespondent mund te jete:

- Nje shoqeri sigurimi qe permbush kriteret ligjore ne perputhje me Ligjin Nr. 52/2014 “Mbi veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit”, Ligjin Nr. 10076, date 12.02.2009 “Mbi Sigurimin e Detyrueshem ne Sektorin e Transportit”, dhe qe eshte Anetare e Byrore Shqiptare te Sigurimit dhe e autorizuar per te leshuar policen e detyrueshme te pergjegjesise ndaj paleve te treta (TPL).
- Nje ent ligjor, i licencuar nga Autoriteti i Mbikeqyrjes Financiare per trajtimin e demeve si trajtues, i cili duhet te plotesoje kriteret si vijon :
  - (i) Te jete i organizuar ne formen e shoqerise tregtare “S.H.A”;
  - (ii) Te kete nje kapital jo me te vogel se 3 000 000 (tre milion) Euro ne trajten e mjeteve monetare likuide te depozituar paraprakisht ne nje llogari qellimore gjate gjithë kohes se ushtrimit te aktivitetit si korrespondent. Kjo llogari mund te preket per pagesa vetem me urdher te BSHS. Shoqeria ka detyrimin ne cdo rast te plotesoje gjendjen e mjeteve monetare te prekura nga BSHS menjehere.
  - (iii) Te kete nje rrjet te plote ekspertesh, vleresuesish dhe juristesh te provuar me dokumente paraprakisht.
  - (iv) Te kete nje eksperience minimale prej 10 (dhjete) vitesh ne tregun e sigurimeve si shoqeri e licencuar ne trajtimin e demeve.

- (v) Te marre miratimin nga Asambleja e Pergjithshme e Anetareve vetem nese ploteson te gjitha kriteret e mesiperme

#### **Neni 4**

#### **Procedura per Emerimin e nje Korrespondenti**

Vetem Byroja do te kete autoritetin, me kerkese te njerit prej anetareve te saj, qe t'i dergoje Byrose Shqiptare te Sigurimit nje kerkese per miratimin e nje korrespondenti te themeluar ne Shqiperi. Kerkesa mund te dergohet me faks ose email.

Aplikimi duhet te shoqerohet me nje dokument qe deklaron se korrespondenti i propozuar bie dakord me emerimin e kerkuar.

Byroja Shqiptare e Sigurimit do te miratoje ose refuzoje emerimin brenda tre muajve nga data e marrjes se kerkeses per emerim nga Byroja perkatese, anetar i te ciles eshte siguruesi kerkues.

Byroja Shqiptare e Sigurimit duhet t'i komunikojte vendimin e saj dhe daten e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi Byrose qe ka bere kerkesen per emerim si dhe korrespondentit perkates.

Neqoftese Byroja Shqiptare e Sigurimit nuk kthen pergjigje brenda afatit te percaktuar, miratimi i emerimit do te konsiderohet i mireqene dhe data e hyrjes ne fuqi do te konsiderohet mbarimi i afatit te periudhes tre mujore.

#### **Neni 5**

#### **Kriteret per Emerimin e nje Korrespondenti**

Korrespondenti duhe te veproje sipas dispozitave te Nenit 3 te kesaj Rregulloreje dhe ne perputhje me rregullat dhe dispozitat e Rregullores se Brendshme te Keshillit te Byrove, dispozitat e ligjit shqiptar mbi sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit, si dhe cdo legjislacioni tjeter te aplikueshem ne Shqiperi.

#### **Neni 6**

#### **Te drejtat dhe detyrimet e Korrespondentit te Emeruar**

1. Korrespondenti do te trajtoje te gjitha kerkesat per demshperblim konform cdo akti apo dispozite ligjore te aplikueshme ne Shqiperi lidhur me pergjegjesine dhe kompensimin e paleve te demtuara dhe sigurimin e detyrueshem motorik, ne emer te Byrose Shqiptare te Sigurimit dhe ne interes te Siguruesit qe ka kerkuar emerimin, per aksidentet qe ndodhin ne Shqiperi qe perfshijne mjetet e siguruara nga Siguruesi qe ka kerkuar emerimin e tij si korrespondent.

2. Korrespondenti eshte i lire te biere dakord me Siguruesin qe ka kerkuar emerimin e tij lidhur me kushtet e rimbursimit te shumave paguar paleve te demtuara dhe metoden e llogaritjes se tarifes se trajtimit, ne perputhje me Rregullorn e Brendshme.

3. Kur nje Byro e huaj merr informacionin se nje nga anetaret e saj ka vendosur te nderprese marreveshjen me nje korrespondent, ajo duhet te informoje menjehere Byrone Shqiptare te Sigurimit. Kjo e fundit gezon te drejten per te percaktuar daten ne te cilen miratimi i saj shfuqizohet.

4. Kur Byroja Shqiptare e Sigurimit ka dhene miratimin per emerimin e nje korrespondenti dhe vendos ta shfuqizojë ate ose mer informacion se korrespondenti perkates deshiron qe t'i shfuqizohet miratimi i emerimit, ajo duhet te njoftoje menjehere Byrone qe ka bere kerkesen per miratim te emerimit te korrespondentit ne fjale dhe gjithashtu t'i beje me dije kesaj te fundit daten kur miratimi i emerimit shfuqizohet.

5. Korrespondenti duhet t'i raportoje periodikisht ne menyre analitike dhe sintetike (cdo tre muaj e detyrueshme) Byrose Shqiptare te Sigurimit, lidhur me demet e paguara dhe ne proces trajtimi, si dhe sa here kjo e fundit paraqit kerkesen per nje informacion te tille.

6. Korrespondenti duhet te informoje menjehere (afati maksimal nje jave kalendarike nga data e marrjes se kerkeses per informacion nga BSHS) Byrone Shqiptare te Sigurimit, lidhur me procesin e trajtimit dhe pageses se cdo kerkese per demshperblim, per te cilen eshte paraqitur nja ankese prane Byrose Shqiptare te Sigurimit.

### **Neni 7 Te drejtat dhe detyrimet e Byrose**

Byroja Shqiptare e Sigurimit ka te drejte te monitoroje dhe mbikqyre trajtimin dhe pagesat e demeve.

Byroja Shqiptare e Sigurimit eshte ekskluzivisht kompetente per te trajtuar dhe paguar kerkesat per demshperblim ne emer te Byrose dhe per interes te Siguruesit qe ka kerkuar miratimin e saj per emerim korrespondenti. BSHS duhet te informoje palen/t e demtuara lidhur me kete kompetence te saj dhe t'i percjelle korrespondentit cdo informacion lidhur me rastin ne fjale.

Megjithate, Byroja Shqiptare e Sigurimit, ne cdo kohe dhe pa qene e detyruar te justifikojë vendimin e e saj, mund t'i heqe te drejten korrespondentit per te trajtuar nje kerkese per demshperblim dhe t'a trajtoje vete rastin ne fjale.


BSHS, sapo te marre njoftimin per nje aksident motorik, informon dhe i dergon dokumentat perkatese korrespondentit per te vazhduar me procedurat e metejshme te trajtimit dhe pageses se demit.

Cdo marreveshje e lidhur midis korrespondentit dhe siguruesit qe ka kerkuar emerimin e tij nuk eshte e detyrueshme per Byrone Shqiptare te Sigurimit.

Byroja Shqiptare e Sigurimit, sapo te marre nje ankese nga palet e treta, kerkon informacion te detajuar nga korrespondenti lidhur me trajtimin e demit perkates, ne perputhje me Rregulloren e Brendshme te Keshillit te Byrove dhe Ligjin kombetar mbi sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit.

### **Neni 8 Shfuqizimi i Emerimit**

Byroja Shqiptare e Sigurimit shfuqizon emerimin e nje korrespondenti te miratuar me pare ne rastin kur:



- Korrespondenti nuk ka zbatuar kriteret e percaktuara ne Nenin 3 te kesaj Rregulloreje;
- Korrespondenti nuk ka zbatuar dispozitat ligjore te Rregullores se Brendshme, Ligjit kombetar mbi sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit dhe cdo legjislacioni tjeter perkates mbi sigurimet;
- Korrespondenti kerkon me deshiren e tij shfuqizimin e emerimit;
- Shfuqizimi kerkohet nga Siguruesi qe ka kerkuar emerimin e korrespondentit ose Byroja, anetar i te ciles eshte ky sigurues;
- Ne rastin kur Siguruesit qe ka kerkuar emerimin e korrespondentit i eshte pezulluar ose i eshte shfuqizuar autorizimi per te leshuar TPL-ne e detyrueshme, ose i eshte hequr licenca per te trajtuar dhe paguar deme nga Autoriteti i Mbikeqyrjes Financiare.

### **Neni 9 Dispozita te Vecanta**

Ne rastin kur nje korrespondenti te emeruar i shfuqizohet emerimi, dosjet e demeve qe kane gene ne proces trajtimi, jane paguar, ose jane arkivuar nga korrespondenti deri ne momentin e shfuqizimit, duhet te vazhdojne te trajtohen deri ne fund nga Korrespondenti ne fjale, dhe ne rast rihapjeje apo nje kerkese te re per demshperblim lidhur me keto raste, dosja duhet te trajtohet po nga ky korrespondent deri ne perfundimin e procedures se trajtimit dhe pageses se demit.

Kerkesat per demshperblim lidhur me aksidentet e ndodhura pas dates se shfuqizimit te emerimit te korrespondentit do te trajtohen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, ne rastin kur nuk eshte emeruar nje korrespondent tjeter .

Dispozitat e Rregullores se Brendshme te Keshillit te Byrove aplikohen automatikisht per cdo Nen te parashikuar ne kete Rregullore.

### **Neni 10 Dispozita Kalimtare**

Shoqerite e sigurimit qe veprojne si korrespondente te emeruar do te rikonfirmohen per pozicionin e tyre si korrespondente dhe do te njoftohen perkatesisht.

Entet e tjera qe veprojne si korrespondente te emeruar do te rikonfirmohen per pozicionin e tyre si korrespondente kur veprintaria e tyre te jete ne perputhje me Nenin 3 te kesaj Rregulloreje dhe do te njoftohen perkatesisht. Limiti kohor qe do t'u jepet per te zbatuar dispozitat e kesaj Rregulloreje te re do te jete 6 (gjashte muaj) nga data e miratimit te saj.

### **Neni 11 Mosperputhja me Rregulloren e Brendshme te Keshillit te Byrove**

Ne rast se dispozitat e kesaj rregulloreje jane ne kundërshtim ne Rregulloren e Brendshme, do te aplikohet Rregullorja e Brendshme e Keshillit te Byrove.

### **Neni 12 Data e hyrjes ne fuqi**

Kjo Rregullore hyn ne fuqi nje dite pas miratimit te saj nga Asambleja e Pergjithshme e Anetareve te Byrose Shqiptare te Sigurimit.

